

Rregullore (KE) Nr 1592/2002 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 15 Korrikut 2002 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e një Agjencie Evropiane për Sigurinë e Aviacionit (Tekst kuptimi i të cilit lidhet me EHP-në)

Gazeta Zyrtare L 240, 07.09.2002 Fq. 0001-0021

Rregullore (KE) Nr 1592/2002 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 15 Korrikut 2002 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e një Agjencie Evropiane për Sigurinë e Aviacionit (Teksti kuptimi i të cilit lidhet me EHP-në)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin e themelues të Komunitetit Evropian, dhe veçanërisht nenin 80 pika (2) e tij,

Duke patur parasysh propozimin e Komisionit (1),

Duke pasur parasysh Mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social (2),

Duke u konsultuar me Komitetin e Rajoneve,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 251 të Traktatit (3),

Ndërsa,

(1) Duhet të sigurohet një nivel i lartë dhe i njëtrajtshëm i mbrojtjes së qytetarëve evropianë në aviacionin civil, nëpërmjet miratimit të rregullave të përbashkëta të sigurisë dhe nëpërmjet masave që sigurojnë që produktet, personat dhe organizatat në Komunitet të pajtohen me këto rregulla dhe ato që janë miratuar për të mbrojtur ambientin. Kjo do të kontribuojë në lehtësimin e lëvizjes së lirë të mallrave, personave dhe organizatave në tregun e brendshëm.

(2) Për pasojë, produktet aeronautike duhet t'i nënshtrohen çertifikimit për të verifikuar që ata përmbushin kërkesat thelbësore të përshtatshmërisë për fluturim dhe mbrojtjen e

ambientit në lidhje me aviacionin civil. Duhet të zhvillohen kërkesa të përshtatshme thelbësore brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje për të mbuluar përdorimin e avionëve dhe liçensimin e ekuipazhit të fluturimit dhe zbatimin e Rregullores për avionët e vendeve të treta dhe, pas kësaj, në sfera të tjera në fushën e sigurisë së aviacionit civil.

(3) Me qëllim që të reagohet ndaj shqetësimeve në rritje për shëndetin dhe mirëqenien e pasagjerëve gjatë fluturimeve, është e nevojshme të zhvillohen dizeno avionësh që mbrojnë më mirë sigurinë dhe shëndetin e pasagjerëve.

(4) Rezultatet e hetimeve të aksidenteve ajrore duhet të trajtohen si një çështje urgjence, veçanërisht kur kanë të bëjnë me dizeno difektoze të avionit dhe/ose çështje funksionimi, me qëllim që të sigurohet besimi i konsumatorit në transportin ajror.

(5) Konventa e Aviacionit Civil Ndërkombëtar, e nënshkruar në Çikago, më 7 dhjetor 1944 (“Konventa e Çikagos”), në të cilën janë palë të gjithë Vendet Anëtare, parashikon tashmë standardet minimale për të garantuar sigurinë e aviacionit civil dhe mbrojtjen e ambientit lidhur me të. Kërkesat dhe rregullat thelbësore Komunitare të miratuara për zbatimin e tyre duhet të sigurojnë që Shtetet Anëtare të përmbushin detyrimet e tyre të vendosura nga Konventa e Çikagos, duke përfshirë ato kundrejt vendeve të treta.

(6) Produktet, pjesët dhe pajisjet aeronautike duhet të certifikohen menjëherë nëse konstatohet të jenë në përputhje me kërkesat thelbësore për përshtatshmërinë për fluturim dhe mbrojtjen e ambientit, të parashikuara nga Komuniteti në përputhje me standardet e caktuara nga Konventa e Çikagos. Komisioni duhet të ketë kompetenca të zhvillojë rregullat zbatuese të nevojshme.

(7) Me qëllim që të arrihen objektivat komunitare në lidhje me lirinë e lëvizjes së mallrave, personave dhe shërbimeve, si dhe ato të politikës së përbashkët të transportit, Shtetet Anëtare, pa patur kërkesa ose vlerësime të tjera, duhet të pranojnë produktet, pjesët dhe pajisjet, organizatat dhe personat e certifikuar në përputhje me këtë Rregullore dhe rregullat e saj zbatuese.

(8) Duhet të parashikohet fleksibiliteti i mjaftueshëm për trajtimin e rrethanave të veçanta si masat emergjente të sigurisë, nevojat e paparashikuara ose të kufizuara dhe duhet të merren masa edhe për të arritur një nivel të barazvlefshëm sigurie me anë të mjeteve të

tjera. Shtetet Anëtare duhet të kenë të drejtën të bëjnë përjashtime nga kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe rregullat e saj zbatuese, me kusht që ato të jenë rigorozisht të kufizuara në objekt dhe duke iu nënshtuar kontrollit të përshtatshëm komunitar.

(9) Përmbushja e objektivave të kësaj Rregulloreje mund të arrihet me efikasitet nëpërmjet bashkëpunimit me vendet e treta. Në një rast të tillë, dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe rregullat e saj zbatuese mund të përshtaten nëpërmjet marrëveshjeve të përfunduara nga Komuniteti me këto vende. Në mungesë të këtyre marrëveshjeve, Shtetet Anëtare duhet të lejohen, duke iu nënshtuar kontrollit të përshtatshëm komunitar, të njohin aprovimet e dhëna për produktet, pjesët dhe pajisjet e huaja dhe organizatat dhe personelin nga një vend i tretë.

(10) Është e nevojshme të caktohen masa të përshtatshme për të siguruar mbrojtjen e nevojshme të të dhënave me ndjeshmëri të sigurisë dhe t'i jepet publikut informacion i përshtatshëm në lidhje me nivelin e sigurisë së aviacionit civil dhe mbrojtjen e ambientit në lidhje me të, duke marrë parasysh Rregulloren (KE) Nr 1049/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 30 majit 2001 në lidhje me të drejtën e njohjes së publikut me dokumentet (4) e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit dhe legjislacionin përkatës të brendshëm.

(11) Ka nevojë për masa më të mira në të gjitha fushat e mbuluara nga kjo Rregullore, kështu që detyra të caktuara që tashmë kryhen në nivel Komunitar ose kombëtar duhet të kryhen nga një organ i vetëm ekspertësh i specializuar. Kështu, është e nevojshme që brenda strukturës ekzistuese institucionale të Komunitetit dhe balancës së pushteteve, të themelohet një Agjenci Evropiane e Aviacionit Civil që është e pavarur në lidhje me çështjet teknike dhe ka pavarësi ligjore, administrative dhe financiare. Për këtë qëllim, është e nevojshme dhe e përshtatshme që ai duhet të jetë një organ komunitar që ka personalitet ligjor dhe që ushtron funksione ekzekutive që i jepen atij nga kjo Rregullore.

(12) Me qëllim që të asistojë si duhet Komunitetin, Agjencia duhet të lejohet të zhvillojë ekspertizën e saj në të gjitha aspektet e sigurisë së aviacionit civil dhe mbrojtjes së ambientit të mbuluara nga kjo Rregullore. Ajo duhet të asistojë Komisionin në përgatitjen e legjislacionit të nevojshëm dhe të asistojë Shtetet Anëtare dhe industrinë në zbatimin e saj. Duhet të jetë në gjendje të nxjerrë specifikimet dhe materialin udhëzues e të bëjë konstatimet teknike dhe të lëshojë certifikatat që kërkohen dhe duhet të asistojë

Komisionin në monitorimin e zbatimit të kësaj Rregulloreje dhe të rregullave të saj zbatuese dhe duhet t'i jepet autoriteti i nevojshëm për të përmbushur këto detyra.

(13) Komisioni dhe Shtetet Anëtare duhet të përfaqësohen brenda një Bordi Menaxhimi me qëllim që të kontrollojnë në mënyrë efektive funksionet e Agjencisë. Këtij Bordi duhet t'i jepen kompetencat e nevojshme për të ngritur buxhetin, të verifikojë zbatimin e tij, të miratojë rregulla të përshtatshme financiare, të vendosë rregulla transparente pune për vendim-marrjen nga Agjencia dhe të emërojë një Drejtor Ekzekutiv. Është gjithashtu e përshtatshme që Agjencia të lejohet të kryejë kërkime dhe të organizojë bashkërendimin e përshtatshëm me Komisionin dhe Shtetet Anëtare. Është e nevojshme që Agjencia të asistojë Komunitetin dhe Shtetet e tij Anëtare në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke përfshirë harmonizimin e rregullave, njohjen e aprovimeve dhe bashkëpunimit teknik, dhe të ketë të drejtën të vendosë marrëdhënie të përshtatshme me autoritetet aeronautike të vendeve të treta dhe organizatat ndërkombëtare kompetente për çështjet e mbuluara nga kjo Rregullore.

(14) Interesi publik kërkon që Agjencia të bazojë veprimet e saj në lidhje me sigurinë vetëm mbi ekspertizë të pavarur, duke zbatuar në mënyrë rigorozë këtë Rregullore dhe rregullat e miratuara nga Komisioni për zbatimin e saj. Për këtë qëllim, të gjitha vendimet e Agjencisë për sigurinë, duhet të merren nga Drejtori i saj Ekzekutiv, të cilit duhet t'i lejohet një shkallë e lartë fleksibiliteti për marrjen e këshillave dhe për organizimin e funksionimit të brendshëm të Agjencisë. Megjithatë, nëse Agjencia duhet të zhvillojë projekt-rregullore të një natyre të përgjithshme që duhet të zbatohen nga autoritetet e brendshme, Shtetet Anëtare duhet të përfshihen në procesin e përgatitjes së vendimit.

(15) Është e nevojshme të garantohet që palët e prekura nga vendimet e marra nga Agjencia, të kenë në dispozicion mjetet e nevojshme të mbrojtjes në një mënyrë që të përshtatet me karakterin e veçantë të fushës së aviacionit. Duhet të ngrihet një mekanizëm i përshtatshëm ankimi në mënyrë që vendimet e Drejtorit Ekzekutiv të mund t'i nënshtrohen ankimit tek një Bord i specializuar Apeli, vendimet e të cilit, nga ana tjetër, të jenë të hapura për t'u kundërshtuar tek Gjykata e Drejtësisë.

(16) Me qëllim që të garantohet autonomia e plotë dhe pavarësia e Agjencisë, duhet të jepet një buxhet autonom, shumat e të cilit të vijnë kryesisht nga kontributi i Komunitetit dhe nga tarifat e paguara nga përdoruesit e sistemit. Procedura buxhetore e Komunitetit duhet të zbatohet në masën që ka të bëjë me kontributin e Komunitetit dhe nga

subvencione të tjera që i ngarkohen buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian. Auditimi i llogarive duhet të merret përsipër nga Gjykata e Auditimit.

(17) Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Rregulloreje duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE e 28 Qershorit 1999 që cakton procedurat për ushtrimin e funksioneve ekzekutive që i jepen komisionit (5).

(18) Meqenëse objektivat e veprimit të propozuar, që është caktimi dhe zbatimi i njëtrajtshëm i rregullave të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil dhe mbrojtjes së ambientit, nuk mund të arrihen në masën e mjaftueshme nga Shtetet Anëtare dhe në këtë mënyrë, për shkak të objektit mbarë-evropian të kësaj Rregulloreje, mund të arrihen më mirë në nivel komunitar, Komuniteti mund të miratojë masa, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, sikurse parashikohet në Nenin 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sikurse parashikohet në atë nen, kjo Rregullore nuk shkon tej asaj që është e nevojshme për të arritur ato objektiva.

(19) Para se të hapet ndonjë zyrë lokale e Agjencisë, duhet të vendosen rregulla të përgjithshme për të sqaruar se cilat kërkesa duhet të përmbushen dhe cilat kontribute duhet të jepen nga Shtetet Anëtare përkatëse.

(20) Është njohur që duhet të mbështetet përfshirja e vendeve evropiane që nuk janë Anëtare të Bashkimit Evropian, për të siguruar një dimension të përshtatshëm pan-Evropian me qëllim që të lehtësohet përmirësimi i sigurisë së aviacionit civil në të gjithë Evropën. Vendet evropiane që kanë lidhur marrëveshje me Komunitetin për të miratuar dhe zbatuar *acqui*-në komunitare në fushën e mbuluar nga kjo Rregullore, duhet të marrin pjesë në punën e tij në bazë të kushteve që duhet të bihet dakord në kuadrin e këtyre marrëveshjeve.

(21) Është objektiv i përgjithshëm që transferimi i funksioneve dhe detyrave nga Shtetet Anëtare, duke përfshirë ato që rrjedhin nga bashkëpunimi i tyre nëpërmjet Autoriteteve të Përbashkëta të Aviacionit, tek Agjencia duhet të realizohet me efektivitet, pa ulur nivelet e larta aktuale të sigurisë, dhe pa asnjë ndikim negativ mbi afatet e certifikimit. Masat e përshtatshme duhet të merren për të rregulluar tranzicionin e nevojshëm.

(22) Kjo Rregullore vendos një kuadër të përshtatshëm dhe të plotë për certifikimin ambientalist të produkteve aeronautike si dhe për përkufizimin dhe zbatimin e kërkesave

teknike dhe procedurave administrative të përbashkëta në fushën e aviacionit civil. Direktiva e Këshillit 80/51/KEE e 20 Dhjetorit 1979 mbi kufizimin e emetimit të zhurmës nga avionët subsonikë (7) duhet të shfuqizohet në kohën e duhur, pa cënuar certifikimin e produkteve, personave dhe organizatave që është kryer në përputhje me këto akte legislative.

(23) Kjo Rregullore zbatohet për çdo fushë tjetër në lidhje me sigurinë e aviacionit civil mbi bazën e një propozimi të ardhshëm në përputhje me Traktatin,

KANË MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

KAPITULLI I

PARIMET

Neni 1

Fusha e zbatimit

1. Kjo Rregullore zbatohet për:

(a) dizenjimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe operimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike, si dhe për personelin dhe organizatat e përfshira në dizenjimin, prodhimin dhe mirëmbajtjen e këtyre produkteve, pjesëve dhe pajisjeve;

(b) personelin dhe organizatat e përfshira në veprimtarinë e avionit.

2. Kjo Rregullore nuk zbatohet nëse produktet, pjesët, pajisjet, personeli dhe organizatat e përmendura në paragrafin 1 janë përfshirë në shërbime ushtarake, doganore, policore ose të ngjashme. Shtetet Anëtare marrin përsipër të sigurojnë që këtyre shërbimeve t'u kushtohet një vëmendje në masën që është praktike për objektivat e kësaj Rregulloreje.

Neni 2

Objekti

1. Objekti kryesor i kësaj Rregulloreje është vendosja dhe ruajtja e një niveli të lartë të njëtrajtshëm të sigurisë së aviacionit civil në Evropë.

2. Objektiva shtesë, në fushat e mbuluara nga kjo Rregullore, janë si më poshtë:

(a) sigurimi i një niveli të lartë të njëtrajtshëm të mbrojtjes së ambientit;

- (b) lehtësimi i lëvizjes së lirë të mallrave, personave dhe shërbimeve;
- (c) nxitja e kursimit në proceset rregullatore dhe të certifikimit dhe mënjanimi i mbivendosjes në nivelin e brendshëm dhe evropian;
- (d) dhënia e ndihmës Shteteve Anëtare për të përmbushur detyrimet e tyre në bazë të Konventës së Çikagos, duke parashikuar një bazë për interpretim të përbashkët dhe zbatim të njëtrajtshëm të dispozitave të saj dhe duke siguruar që dispozitat e saj të merren parasysh si duhet në këtë Rregullore dhe në rregullat e hartuara për zbatimin e saj;
- (e) nxitja e qëndrimeve komunitare në lidhje me standardet dhe rregullat e sigurisë së aviacionit civil në të gjithë botën duke vendosur bashkëpunim të përshtatshëm me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare.

3. Mjetet për arritjen e objektivave të caktuara në paragrafët 1 dhe 2 janë:

- (a) përgatitja, miratimi dhe zbatimi i njëtrajtshëm i të gjithë akteve të nevojshëm;
- (b) njohja, pa kërkesa shtesë, e certifikatave, liçencave, aprovimeve ose dokumenteve të tjera të dhëna për produktet, personelin dhe organizatat në përputhje me këtë Rregullore dhe rregullat në zbatim të saj;
- (c) themelimi i një Agjencie Evropiane për Sigurinë e Aviacionit;
- (d) zbatimi i njëtrajtshëm i të gjithë akteve të nevojshme nga autoritetet e brendshme të aviacionit dhe Agjencia brenda sferës së tyre përkatëse të përgjegjësisë.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllimin e kësaj Rregulloreje:

- (a) “mbikëqyrje e vazhduar” janë detyrat që duhet të zbatohen për të verifikuar vazhdimin e përmbushjes së kushteve brenda të cilave është dhënë certifikata në çdo moment brenda afatit të vlefshmërisë së saj, si dhe marrja e masave garantuese;
- (b) “Konventa e Çikagos” është Konventa mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar dhe shtojcat e saj, të nënshkruar në Çikago më 7 Dhjetor 1944;
- (c) “produkt” është një avion, motor ose helikë;
- (d) “pjesë dhe pajisje” është një instrument, pajim, mekanizëm, pjesë, aparat, pjesë dytësore ose aksesor, duke përfshirë pajimet e komunikimit, që përdoret ose nevojitet për t’u përdorur në operimin ose kontrollimin e një avioni në fluturim dhe që instalohet ose bashkëngjitet avionit. Ato përfshijnë pjesët e strukturës, motorit dhe helikës;
- (e) “certifikim” është çdo formë njohjeje që një produkt, pjesë ose pajisje, organizatë ose person respekton kërkesat e zbatueshme duke përfshirë dispozitat e kësaj Rregulloreje

dhe rregullat në zbatim të saj, si dhe nxjerrjen e çertifikatës përkatëse që vërteton këtë përputhje;

(f) “subjekt i kualifikuar” është një organ që mund të zbatojë detyra çertifikimi nën kontrollin dhe përgjegjësinë e Agjencisë;

(g) “çertifikatë” është aprovimi, liçenca ose një dokument tjetër i lëshuar si rezultat i çertifikimit.

KAPITULLI II KËRKESA THEMELORE

Neni 4

Parimet bazë dhe zbatueshmëria

1. Avioni, duke përfshirë çdo produkt, pjesë ose pajisje të instaluar, që janë:

(a) dizenuar ose prodhuar nga një organizatë për të cilën Agjencia ose një Shtet Anëtar garanton mbikëqyrjen e sigurisë; ose

(b) regjistruar në një Shtet Anëtar; ose

(c) regjistruar në një shtet të tretë dhe përdorur nga një operator për të cilin çdo Shtet Anëtar garanton mbikëqyrjen e operacioneve;

përputhet me këtë Rregullore përveç kur mbikëqyrja e tyre rregullatore e sigurisë i është deleguar një vendi të tretë dhe ato nuk përdoren nga një operator komunitar.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet për avionët e përmendur në Shtojcën II.

3. Kjo Rregullore nuk cenon të drejtat e vendeve të treta sipas parashikimeve të konventave ndërkombëtare, veçanërisht Konventës së Çikagos.

Neni 5

Përshtatshmëria për fluturim

1. Avioni i përmendur në nenin 4 pika (1) përmbush kërkesat thelbësore për përshtatshmërinë për fluturim, të përcaktuara në Shtojcën I.

2. Përputhshmëria e avionit të regjistruar në një Shtet Anëtar, dhe e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve të montuara në të, përcaktohet në përputhje me sa më poshtë:

(a) Produktet do të kenë një çertifikatë tip. Çertifikata tip dhe çertifikimi i ndryshimeve në këtë çertifikatë tip, duke përfshirë çertifikatat suplementare tip, lëshohen nëse kërkuesi

tregon që produkti përputhet në bazë të certifikatës tip të përcaktuar në nenin 15, të caktuar për të siguruar përmbushjen e kërkesave thelbësore të përmendura në paragrafin 1, dhe nëse nuk ka ndonjë tipar ose karakteristikë që e bën atë të pasigurt për përdorim. Çertifikata tip do të mbulojë produktin, duke përfshirë të gjitha pjesët dhe pajisjet e montuara në të.

(b) Pjesët dhe pajisjet mund të pajisen me certifikata specifike nëse ato demonstrojnë që përmbushin specifikimet e detajuara të përshtatshmërisë për fluturim, të caktuara për të siguruar përputhjen me kërkesat thelbësore të përmendura në paragrafin 1.

(c) Çdo avion pajiset me një certifikatë individuale të përshtatshmërisë për fluturim nëse demonstroi që përputhet me dizenjon e tipit të aprovuar në certifikatën e tipit të tij dhe që dokumentacioni, inspektimet dhe testet përkatëse demonstrojnë që avioni është në gjendje për operim të sigurt. Kjo certifikatë për përshtatshmërinë për fluturim mbetet e vlefshme për aq sa ajo nuk pezullohet, anulohet ose shfuqizohet dhe për aq sa avioni mirëmbahet në përputhje me kërkesat thelbësore në lidhje me përshtatshmërinë për fluturim, të parashikuar në pikën 1.d të Shtojcës I dhe rregullat zbatuese të përmendura në paragrafin 4.

(d) Organizatat përgjegjëse për dizenjon, prodhimin dhe mirëmbajtjen e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve demonstrojnë aftësinë dhe mjetet e tyre për të përmbushur përgjegjësitë që kanë të bëjnë me privilegjet e tyre. Nëse nuk pranohet ndryshe, këto aftësi dhe mjete njihen nëpërmjet lëshimit të një aprovimi të organizatës. Privilegjet e dhëna për organizatën e aprovuar dhe objekti i aprovimit përcaktohet në termat e aprovimit.

Po kështu:

(e) personelit përgjegjës për nxjerrjen e një produkti, pjese apo pajisjeje pas mirëmbajtjes mund t'i kërkohet të zotërojë certifikatën e përshtatshme (“çertifikata e personelit”);

(f) aftësia e organizatave trajnuese të mirëmbajtjes për të përmbushur përgjegjësitë në lidhje me privilegjet e tyre në raport me lëshimin e certifikatave të përmendura në pikën (e) mund të njihet nëpërmjet lëshimit të një aprovimi.

3. Nëpërmjet devijimit nga paragrafët 1 dhe 2:

(a) një leje për fluturim mund të lëshohet nëse demonstron që avioni është në gjendje të kryejë me siguri një fluturim bazë. Atij i caktohen kufizime të përshtatshme, veçanërisht për të mbrojtur sigurinë e palëve të treta;

(b) një certifikatë e kufizuar e përshtatshmërisë për fluturim mund të lëshohet për një avion për të cilin nuk është dhënë një certifikatë tip në përputhje me paragrafin 2(a). Në

këtë rast, avioni që provohet në përmbushjen e specifikimeve të caktuara të përshtatshmërisë për fluturim dhe devijimet nga kërkesat thelbësore të përmendura në paragrafin 1, duhet të japë siguri të përshtatshme në lidhje me qëllimin. Avioni i përshtatshëm për këto çertifikata të kufizuara dhe kufizimet për përdorimin e këtij avioni përcaktohen në përputhje me rregullat zbatuese të përmendura në paragrafin 4;

(c) nëse numri i avionit i të njëjtit tip të përshtatshëm për një çertifikatë të kufizuar të përshtatshmërisë për fluturim e justifikon, mund të lëshohet një çertifikatë tipi e kufizuar dhe të caktohet një bazë çertifikate tip e përshtatshme.

4. Komisioni, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 54 pika (3) , miraton rregullat për zbatimin e këtij neni, duke përcaktuar veçanërisht:

(a) kushtet për t'i vendosur dhe njoftuar një kërkuesi bazën e çertifikatës së tipit të zbatueshme për produktin;

(b) kushtet për t'i vendosur dhe njoftuar një kërkuesi specifikimet e detajuara të përshtatshmërisë për fluturim që zbatohen për pjesët dhe pajisjet;

(c) kushtet për t'i vendosur dhe njoftuar një kërkuesi specifikimet e veçanta për përshtatshmërinë e fluturimit që zbatohen për një avion të përshtatshëm për një çertifikatë të kufizuar të përshtatshmërisë për fluturim;

(d) kushtet për të nxjerrë dhe shpërndarë informacion të detyruar me qëllim që të sigurohet përshtatshmëria e vazhdueshme për fluturim e produktit;

(e) kushtet për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose anulimin e çertifikatave tip, çertifikatave të kufizuara tip, aprovimit të ndryshimeve për çertifikatat tip, çertifikatave individuale të përshtatshmërisë për fluturim, çertifikatave të kufizuara të përshtatshmërisë për fluturim, lejeve për të fluturuar dhe çertifikatave për produktet, pjesët ose pajisjet, duke përfshirë:

(i) kushtet për kohëzgjatjen e këtyre çertifikatave dhe kushtet për rinovimin e çertifikatave nëse është përcaktuar një kohëzgjatje e prerë;

(ii) kufizimet e zbatueshme për çështjen e kufizimit për të fluturuar. Këto kufizime veçanërisht duhet të prekin çështjet e mëposhtme:

- qëllimin e fluturimit,

- hapësirën ajrore që përdoret për fluturim,

- kualifikimin e ekuipazhit të fluturimit,

- transportin e personave të ndryshëm nga ekuipazhi i fluturimit;

(iii) avionin e përshtatshëm për çertifikata të kufizuara të përshtatshmërisë për fluturim, dhe kufizimet përkatëse;

(f) kushtet për të lëshuar, mbajtur, ndryshuar, pezulluar ose anuluar aprovime për organizatën që kërkohen në përputhje me paragrafin 2(d) dhe (f) dhe kushtet në të cilat këto aprovime nuk duhet të kërkohen;

(g) kushtet për të lëshuar, mbajtur, ndryshuar, pezulluar ose anuluar revokime personeli që kërkohen në përputhje me paragrafin 2(e);

(h) përgjegjësitë e zotëruesve të certifikatave;

(i) si avionët që nuk përmenden në paragrafin 1 që nuk mbulohen nga paragrafi 2 ose 3 duhet të demonstrojnë që përmbushin kërkesat thelbësore.

5. Për caktimin e rregullave zbatuese të përmendura në paragrafin 4, Komisioni kujdeset në mënyrë të veçantë që ato të:

(a) reflektojnë gjendjen e teknikës dhe të praktikave më të mira në fushën e përshtatshmërisë për fluturim;

(b) marrë parasysh eksperiencën mbarëbotërore për shërbimin e avionëve, dhe përparimin shkencor dhe teknik;

(c) lejojë reagimin e menjëhershëm për të përcaktuar shkaqet e aksidenteve dhe incidenteve serioze.

Neni 6

Kërkesa thelbësore për mbrojtjen e ambientit

1. Produktet, pjesët dhe pajisjet përmbushin kërkesat për mbrojtjen e ambientit që parashikohen në Shtojcën 16 të Konventës së Çikagos që është nxjerrë në nëntor 1999, përveç shtojcave të saj.

2. Në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 54 pika (3), paragrafi 1 i këtij neni mund të përshtatet, me qëllim që ai të përputhet me ndryshimet e mëvonshme të Konventës së Çikagos dhe Shtojcave të saj, që hyjnë në fuqi pas miratimit të kësaj Rregulloreje dhe që bëhen të zbatueshme në të gjithë Shtetet Anëtare, në masën që këto përputhje nuk e zgjerojnë fushën e zbatimit të kësaj Rregulloreje.

3. Komisioni parashikon rregulla për zbatimin e paragrafit 1, duke përdorur sipas nevojës përmbajtjen e shtojcave të përmendura në paragrafin 1, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 54 pika (3).

Neni 7

Licëncimi i operacioneve ajrore dhe ekuipazhit të fluturimit

Në lidhje me parimet bazë, kërkesat e zbatueshmërisë dhe thelbësore për fushat e mbuluara nga neni 1 pika (1)(b), Komisioni, menjëherë sapo të jetë e mundur, i paraqet propozime për këtë, Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

Neni 8

Njohja e certifikatave

1. Shtetet Anëtare, pa pasur kërkesa dhe vlerësime të mëtejshme teknike, njohin certifikatat e lëshuara në përputhje me këtë Rregullore. Nëse njohja fillestare bëhet për një qëllim ose për qëllime të caktuara, çdo njohje e mëvonshme mbulon vetëm të njëjtin qëllim(e).
2. Në pritje të miratimit të rregullave zbatuese të përmendura në nenin 5 pika (4), dhe pa cënuar nenin 57 pika (2), certifikatat që nuk mund të lëshohen në përputhje me këtë Rregullore mund të lëshohen mbi bazën e rregullave të brendshme të zbatueshme.

Neni 9

Pranimi i aprovimeve të vendeve të treta

1. Nëpërmjet devijimit nga dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe rregullave të miratuara për zbatimin e saj, Agjencia ose autoritetet e aviacionit në Shtetet Anëtare mund të lëshojnë certifikata mbi bazën e certifikatave të lëshuara nga autoritetet aeronautike të një vendi të tretë, sipas parashikimit në marrëveshjet e njohjes ndërmjet Komunitetit dhe atij vendi të tretë.
2. (a) Në mungesë të një marrëveshjeje të lidhur nga Komuniteti, një Shtet Anëtar ose Agjencia mund të lëshojë certifikata mbi bazën e certifikatave të lëshuara nga autoritetet kompetente të një vendi të tretë në zbatim të një marrëveshjeje të lidhur nga ai Shtet Anëtar me vendin e tretë në fjalë para hyrjes në fuqi të dispozitave përkatëse të kësaj Rregulloreje dhe që i janë njoftuar Komisionit dhe Shteteve të tjera Anëtare. Agjencia mund të nxjerrë ato certifikata ne emër të çdo Shteti Anëtar në zbatim të një marrëveshjeje të përfunduar nga një prej Shteteve Anëtare me vendin e tretë në fjalë.
(b) Nëse Komisioni është i mendimit që:
 - dispozitat e një marrëveshjeje ndërmjet një Shteti Anëtar dhe një vendi të tretë nuk do të parashikonin një nivel sigurie të barasvlefshme me atë që përcaktohet nga kjo Rregullore dhe rregullat e saj zbatuese, dhe/ose
 - një marrëveshje e tillë do të bënte diskriminim ndërmjet Shteteve Anëtare pa patur arsye detyruese për sigurinë ose është në kundërshtim me politikën e jashtme komunitare kundrejt një vendi të tretë,

ai, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 54 pika (2), mund t'i kërkojë Shtetit Anëtar përkatës të ndryshojë marrëveshjen ose të pezullojë zbatimin e saj, apo të heqë dorë prej saj, në përputhje me nenin 307 të Traktatit.

(c) Shtetet Anëtare marrin të gjitha masat e nevojshme menjëherë sapo të jetë e mundur për të hequr dorë prej marrëveshjeve pas hyrjes në fuqi të një marrëveshjeje ndërmjet Komunitetit dhe vendit të tretë në fjalë, për ato fusha të mbuluara nga marrëveshja e fundit.

Neni 10

Dispozitat e fleksibilitetit

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe rregullat e miratuara në zbatim të saj nuk e pengojnë një Shtet Anëtar të reagojë menjëherë në lidhje me një problem sigurie që ka të bëjë me një produkt, person ose organizatë që rregullohet nga dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Nëse problemi i sigurisë është rezultat i:

(a) një niveli të papërshtatshëm të sigurisë që rrjedh nga zbatimi i kësaj Rregulloreje; ose

(b) një mangësie në këtë Rregullore ose në rregullat e zbatimit të saj;

Shtetet Anëtare i njoftojnë menjëherë Agjencisë, Komisionit dhe Shteteve të tjera Anëtare masat e marra dhe shkaqet për to.

2. Komisioni, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 54 pika (3), vendos nëse një nivel i papërshtatshëm sigurie ose një mangësi në këtë Rregullore ose në rregullat e zbatimit të saj justifikon zbatimin e mëtejshëm të masave të miratuara në përputhje me paragrafin 1. Në këtë rast, ai merr masat e nevojshme për të ndryshuar rregullin përkatës. Nëse masat e Shtetit Anëtar nuk konsiderohen të bazuara, Shteti Anëtar anulon ose ndryshon masat në fjalë.

3. Shtetet Anëtare mund të bëjnë përjashtime nga kërkesat lëndore të parashikuara në këtë Rregullore dhe rregullat e zbatimit të saj në rastin e rrethanave operationale urgjente të paparashikuara ose nevojave operationale të një kohëzgjatjeje të kufizuar, me kusht që niveli i sigurisë nëpërmjet kësaj të mos ndikohet negativisht. Agjencia, Komisioni dhe Shtetet e tjera Anëtare njoftohen për çdo përjashtim të tillë

menjëherë sapo të bëhen të përsëritshëm ose nëse ato lejohen për periudha më të gjata se dy muaj.

4. Nëse masat e vendosura nga një Shtet Anëtar janë më pak kufizuese se dispozitat e zbatueshme komunitare, Komisioni, shqyrton nëse përjashtimet përputhen me objektivin e përgjithshëm të kësaj Rregulloreje ose një rregull tjetër të së drejtës Komunitare. Nëse përjashtimet e dhëna nuk përputhen me objektivat e përgjithshme të sigurisë së kësaj Rregulloreje ose një rregull tjetër i së drejtës komunitare, Komisioni merr një vendim në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 54(4). Në një rast të tillë, Shteti Anëtar anulon përjashtimin.

5. Nëse një nivel i barasvlefshëm mbrojtjeje me atë që arrihet nëpërmjet zbatimit të rregullave zbatuese për nenet 5 dhe 6 mund të arrihet me mjete të tjera, Shtetet Anëtare, pa bërë diskriminim mbi bazën e kombësisë, japin aprovimin në derogim nga këto rregulla zbatuese. Në këto raste, Shteti Anëtar përkatës njofton Komisionin që ai synon të japë këtë aprovim dhe jep arsyet që demonstrojnë nevojën për të devijuar nga rregulli përkatës, si dhe kushtet e parashikuara për të siguruar që të arrihet një nivel i barasvlefshëm mbrojtjeje.

6. Brenda tre muajve nga marrja e njoftimit nga një Shtet Anëtar në përputhje me paragrafin 5, Komisioni fillon procedurën e përmendur në nenin 54 pika (3), me qëllim që të vendosë nëse një aprovim i propozuar në përputhje me paragrafin 5 përmbush kushtet e parashikuara në atë paragraf dhe mund të lejohet. Në një rast të tillë, ai ua njofton vendimin e tij të gjithë Shteteve Anëtare, që kanë të drejtë gjithashtu të zbatojnë atë masë. Dispozitat e nenit 8 zbatohen për masën në fjalë. Rregullat përkatëse zbatuese mund të ndryshohen edhe për të pasqyruar një masë të tillë, duke përdorur procedura transparente në përputhje me nenin 43.

Neni 11

Rrjeti i informacionit

1. Komisioni, Agjencia dhe autoritetet kombëtare të aviacionit, shkëmbejnë çdo informacion që u ofrohet atyre në kontekstin e zbatimit të kësaj Rregulloreje dhe rregullave në zbatim të saj. Subjektet e ngarkuara me hetimin e aksidenteve dhe incidenteve të aviacionit civil, ose me analizën e ndodhive, kanë të drejtën e marrjes së këtij informacioni.

2. Pa cenuar të drejtën e publikut për t'u njohur me dokumentet e Komisionit sipas parashikimit të Rregullores (KE) Nr 1049/2001, Komisioni miraton në përputhje me

procedurën e përmendur në nenin 54 pika (3), masat për shpërndarjen tek palët e interesuara me iniciativë të Komisionit, të informacionit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni. Këto masa, që mund të jenë të përgjithshme ose individuale, bazohen mbi nevojën:

(a) për t'u dhënë personave dhe organizatave informacionin që u duhet për të përmirësuar sigurinë e aviacionit;

(b) për të kufizuar shpërndarjen e informacionit në atë që është rigorozisht e nevojshme për qëllimin e përdoruesve të tij, me qëllim që të sigurojë konfidencialitetin e atij informacioni.

3. Autoritetet e brendshme të aviacionit, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm, marrin masat e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e përshtatshëm të informacionit të marrë prej tyre, në zbatim të paragrafit 1.

4. Me qëllim që të informohet publiku në lidhje me nivelin e përgjithshëm të sigurisë, rishikimi i sigurisë publikohet nga Agjencia çdo vit.

KAPITULLI III

AGJENCIA EVROPIANE E SIGURISË SË AVIACIONIT

SEKSIONI I

DETYRAT

Neni 12

Themelimi dhe funksionet e Agjencisë

1. Me qëllim zbatimin e kësaj Rregulloreje, themelohet Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit, më poshtë referuar si “Agjencia”.

2. Me qëllim sigurimin e funksionimit dhe zhvillimit si duhet të sigurisë së aviacionit civil, Agjencia:

(a) ndërmerr çdo detyrë dhe formulon opinione për të gjitha çështjet e mbuluara nga neni 1 pika (1);

(b) asiston Komisionin duke përgatitur masat që duhet të merren për zbatimin e kësaj Rregulloreje. Nëse këto përbëhen nga rregulla teknike dhe veçanërisht rregulla në lidhje me ndërtimin dhe dizënjon dhe aspekte funksionimi, Komisioni nuk mund të ndryshojë përmbajtjen e tyre pa bashkërendim paraprak me Agjencinë. Agjencia i

jep Komisionit të gjithë mbështetjen teknike, shkencore dhe administrative për të kryer detyrat e tij;

(c) merr të gjitha masat e nevojshme brenda kompetencave që i janë dhënë nga kjo Rregullore ose legjislacioni komunitar;

(d) zhvillon inspektimet dhe hetimet që janë të nevojshme për të përmbushur detyrat e saj;

(e) në fushat e saj të kompetencës, kryen, në emër të Shteteve Anëtare, funksionet dhe detyrat që u caktohen nga Konventat ndërkombëtare të zbatueshme, veçanërisht Konventa e Çikagos.

Neni 13

Masat e Agjencisë

Agjencia, sipas rastit:

(a) nxjerr opinione drejtuar Komisionit;

(b) nxjerr specifikime për çertifikimin, duke përfshirë kodet e përshtatshmërisë për fluturim dhe mjetet e pranueshme të përshtatjes, si dhe çdo material udhëzues për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe rregullave të saj zbatuese;

(c) merr vendimet e përshtatshme për zbatimin e neneve 15, 45 dhe 46.

Neni 14

Opinionet, specifikimet e çertifikimit dhe materiali udhëzues

1. Me qëllim që të asistohet Komisioni në përgatitjen e propozimeve për parimet bazë, zbatueshmërinë dhe kërkesat thelbësore që duhet t'i paraqiten Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe miratimin e rregullave zbatuese, Agjencia përgatit projektet e tyre. Këto projekte i paraqiten Komisionit si opinione nga Agjencia.

2. Agjencia, në përputhje me nenin 43 dhe rregullat e zbatimit të miratuara nga Komisioni, zhvillon:

(a) specifikime për çertifikimin, duke përfshirë kodet e përshtatshmërisë për fluturim dhe mjetet e pranueshme të përshtatshmërisë; dhe

(b) materialin udhëzues;

që përdoret në procesin e çertifikimit.

Këto dokumente pasqyrojnë gjendjen e teknikës dhe praktikat më të mira në fushën përkatëse dhe përditësohen duke marrë parasysh eksperiencën mbarëbotërore të avionëve të shërbimit dhe progresin shkencor dhe teknik.

Neni 15

Çertifikimi i përshtatshmërisë për fluturim dhe ambientalist

1. Në lidhje me produktet, pjesët dhe pajisjet e përmendura në nenin 4(1), Agjencia, sipas rastit dhe sipas parashikimit në Konventën e Çikagos ose Shtojcat e saj, kryen në emër të Shteteve Anëtare funksionet dhe detyrat e shtetit të dizenjës, prodhimit ose regjistrimit nëse ka të bëjë me aprovimin e dizenjës, Për këtë qëllim, ajo veçanërisht:

(a) për çdo produkt për të cilin është kërkuar një certifikatë tip ose një ndryshim në një certifikatë tip, vendos dhe njofton bazën e certifikimit tip. Kjo bazë certifikimi përbëhet nga kodi i zbatueshëm i përshtatshmërisë për fluturim, dispozitat për të cilat është pranuar një nivel ekuivalent sigurie dhe specifikimet e veçanta të detajuara teknike të nevojshme kur tiparet e dizenjimit të një produkti të caktuar ose eksperiencia në operim e tregojnë ndonjë nga dispozitat e kodit të përshtatshmërisë për fluturim të papërshtatshme ose të pamjaftueshme për të siguruar përputhshmëri me kërkesat thelbësore.

(b) për çdo produkt për të cilin kërkohet një certifikatë e kufizuar e përshtatshmërisë për fluturim, vendos dhe njofton specifikimet e veçanta të përshtatshmërisë për fluturim;

(c) për çdo pjesë ose pajisje për të cilat kërkohet një certifikatë, vendoset dhe njoftohen specifikimet e detajuara të përshtatshmërisë për fluturim;

(d) për çdo produkt ose pajisje për të cilin kërkohet një certifikim ambientalist në përputhje me nenin 6, vendosen dhe njoftohen kërkesat e përshtatshme për ambientin;

(e) zhvillon, vetë ose nëpërmjet autoriteteve të brendshme të aviacionit ose subjekteve të kualifikuara, inspektime teknike në lidhje me certifikimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve;

(f) lëshon certifikatat e përshtatshme tip ose ndryshimet përkatëse;

(g) lëshon certifikatat për pjesët dhe pajisjet;

(h) lëshon certifikatat e përshtatshme për ambientin;

(i) ndryshon, pezullon ose anulon certifikatën përkatëse nëse kushtet në bazë të të cilave është dhënë, nuk vazhdojnë të përmbushen ose nëse personi juridik ose fizik që zotëron certifikatën, nuk përmbush detyrimet e caktuara për të, nga kjo Rregullore ose nga rregullat zbatuese të saj;

(j) siguron funksionet e përshtatshmërisë së vazhdueshme për fluturim në lidhje me produktet, pjesët dhe pajisjet që ajo ka certifikuar, duke përfshirë reagimin pa vonesë të tepërt ndaj një problemi sigurie dhe duke lëshuar dhe shpërndarë informacionin e zbatueshëm të detyrueshëm.

2. Në lidhje me organizatat, Agjencia:

(a) zhvillon, vetë ose nëpërmjet autoriteteve të brendshme të aviacionit ose subjekteve të kualifikuara, inspektime dhe auditime të organizatave që ajo certifikon;

(b) lëshon dhe rinovon certifikatat e:

(i) organizatave të dizenjimit; ose

(ii) organizatave të prodhimit që ndodhen brenda territorit të Shteteve Anëtare, nëse kërkohet nga Shtetet Anëtare përkatëse; ose

(iii) organizatave të prodhimit dhe mirëmbajtjes që ndodhen jashtë territorit të Shteteve Anëtare;

(c) ndryshon, pezullon ose anulon certifikatën përkatëse të organizatës nëse kushtet për të cilat ajo është dhënë nuk vazhdojnë të përmbushen, ose nëse organizata përkatëse nuk i përmbush detyrimet e caktuara për të nga kjo Rregullore dhe rregullat për zbatimin e saj.

Neni 16

Monitorimi i zbatimit të rregullave

1. Agjencia kryhen inspektime standardizimi në fushën e mbuluar nga neni 1pika (1), me qëllim që të monitorojë zbatimin nga autoritetet e brendshme të aviacionit të kësaj Rregulloreje dhe të rregullave të saj të zbatimit, dhe i raporton Komisionit.

2. Agjencia zhvillon hetime teknike për të monitoruar efektivitetin e zbatimit të kësaj Rregulloreje dhe të rregullave për zbatimin e saj, duke patur parasysh objektivat e caktuara në nenin 2.
3. Agjencia konsultohet dhe i jep opinionin e vet Komisionit mbi zbatimin e nenit 10.
4. Metodatat e punës së Agjencisë për kryerjen e detyrave të përmendura në Paragrafët 1, 2 dhe 3 u nënshtrohen kërkesave që miratohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 54 pika (2) dhe duke marrë parasysh parimet e parashikuara në nenet 43 dhe 44.

Neni 17

Kërkimi

1. Agjencia mund të zhvillojë dhe financojë kërkime në masën që ka të bëjë vetëm me përmirësimet e aktiviteteve në fushën e kompetencës së saj, pa cenuar të drejtën komunitare.
2. Agjencia bashkërendon aktivitetet e saj të kërkimit dhe zhvillimit me ato të Komisionit dhe të Shteteve Anëtare për të siguruar që politikat dhe veprimet të jenë reciprokisht të njëtrajtshme.
3. Rezultatet e kërkimit të financuar nga Agjencia publikohen, me kusht që ajo të mos i klasifikojë ato si konfidenciale.

Neni 18

Marrëdhëniet ndërkombëtare

1. Agjencia asiston Komunitetin dhe Shtetet Anëtare në marrëdhëniet e tyre me vendet e treta në përputhje me të drejtën përkatëse komunitare. Veçanërisht, ajo asiston në harmonizimin e rregullave dhe njohjen reciproke në lidhje me aprovimet që vërtetojnë zbatimin e pëlqyeshëm të rregullave.
2. Agjencia mund të bashkëpunojë me autoritetet aeronautike të vendeve të treta dhe organizatat ndërkombëtare kompetente për çështjet e mbuluara nga kjo Rregullore në kuadrin e masave të punës që bihet dakord me ato organe, në përputhje me dispozitat përkatëse të Traktatit.
3. Agjencia asiston Shtetet Anëtare për të respektuar detyrimet e tyre ndërkombëtare, veçanërisht ato në bazë të Konventës së Çikagos.

SEKSIONI II

STRUKTURA E BRENDSHME

Neni 19

Statusi ligjor, vendndodhja, zyrat lokale

1. Agjencia është një organ i Komunitetit. Ajo ka personalitet ligjor.
2. Në secilin nga Shtetet Anëtare, Agjencia gëzon zotësinë më të gjerë juridike që u jepet personave juridikë në bazë të ligjeve të tyre. Veçanërisht, ajo mund të përftojë ose disponojë mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe mund të dalë si palë në procese gjyqësore.
3. Agjencia mund të themelojë zyrat e veta lokale në Shtetet Anëtare me pëlqimin e tyre.
4. Agjencia përfaqësohet nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 20

Personeli

1. Rregullorja e Personelit e nëpunësve të Komuniteteve Evropiane, Kushtet e punësimit të punonjësve të tjerë të Komuniteteve Evropiane dhe rregullat e miratuara bashkërisht nga institucionet e Komuniteteve Evropiane për qëllimet e zbatimit të kësaj Rregulloreje të Personelit dhe Kushteve të punësimit, zbatohen për personelin e Agjencisë, pa cënuar zbatimin e nenit 33 të kësaj Rregulloreje për anëtarët e Bordit të Apelit.
2. Pa cënuar nenin 30, kompetencat e dhëna autoritetit emëruar nga Rregullorja e Personelit dhe nga Kushtet e punësimit të punonjësve të tjerë, ushtrohen nga Agjencia në lidhje me personelin e vet.
3. Personeli i Agjencisë përbëhet nga një numër tepër i kufizuar nëpunësish të caktuar ose komanduar nga Komisioni ose Shtetet Anëtare për të kryer detyra drejtuese. Pjesa tjetër e personelit përbëhet nga të punësuar të tjerë të rekrutuar nga Agjencia sipas nevojës për kryerjen e detyrave të saj.

Neni 21

Privilegjet e imunitetit

Protokolli për Privilegjet dhe Imunitetet e Komuniteteve Evropiane zbatohen për Agjencinë.

Neni 22

Detyrimi

1. Detyrimi kontraktual i Agjencisë rregullohet nga ligji i zbatueshëm për kontratën në fjalë.
2. Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Evropiane ka juridiksion për të dhënë vendime në lidhje me çdo dispozitë arbitrazhi që ndodhet në kontratën e përfunduar nga Agjencia.
3. Në rastin e detyrimit jashtë-kontraktor, Agjencia, në përputhje me parimet e përgjithshme të përbashkëta me ligjet e Shteteve Anëtare, dëmshpërblen çdo dëm të shkaktuar nga departamentet e saj ose punonjësit e saj gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.
4. Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion në mosmarrëveshjet në lidhje kompensimin për dëmin e përmendur në paragrafin 3.
5. Detyrimi personal i punonjësve të saj ndaj Agjencisë rregullohet nga dispozitat e përcaktuara në Rregulloren e Personelit ose Kushtet e punësimit të zbatueshme për ta.

Neni 23

Publikimi i dokumenteve

1. Pa çënuar vendimet e marra në bazë të nenit 290 të Traktatit, dokumentet e mëposhtme nxirren në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunitetit:
 - (a) rishikimi i sigurisë i përmendur në nenin 11 pika (4);
 - (b) opinionet që i paraqiten Komisionit në përputhje me nenin 14 pika (1);
 - (c) raportin e përgjithshëm vjetor dhe programin e punës të përmendur në nenin 24 pika (2)(b) dhe (c) përkatësisht.
2. Shërbimet e përkthimit që kërkohen për funksionimin e Agjencisë ofrohen nga Qendra e Përkthimit për organet e Bashkimit Evropian.

Neni 24

Kompetencat e Bordit Drejtues

1. Agjencia do të ketë një Bord Drejtues.
2. Bordi Drejtues:
 - (a) emëron Drejtorin ekzekutiv dhe Drejtorët me propozim të Drejtorit Ekzekutiv në përputhje me nenin 30;
 - (b) para 31 marsit të çdo viti, miraton një raport të përgjithshëm të Agjencisë për vitin pararendës dhe ia paraqet atë Parlamentit Evropian, Këshillit, Komisionit dhe Shteteve Anëtare;
 - (c) para 30 shtatorit të çdo viti dhe pas marrjes së vendimit të Komisionit, miraton programin e punës së Agjencisë për vitin e ardhshëm dhe ia paraqet atë Parlamentit Evropian, Këshillit, Komisionit dhe Shteteve Anëtare; ky program pune miratohet pa cënuar procedurën buxhetore Komunitare vjetore dhe programin legjislativ Komunitar në fushat përkatëse të sigurisë së aviacionit;
 - (d) miraton udhëzime për caktimin e detyrave të çertifikimit, autoriteteve të brendshme të aviacionit ose subjekteve të kualifikuara në marrëveshje me Komisionin;
 - (e) cakton procedura për marrjen e vendimeve nga Drejtori Ekzekutiv sikurse referohet në nenet 43 dhe 44;
 - (f) ushtron funksione në lidhje me buxhetin e Agjencisë në përputhje me nenet 48, 49 dhe 52;
 - (g) emëron anëtarët e Bordit të Apelimit në përputhje me nenin 32;
 - (h) ushtron autoritetin disiplinor mbi Drejtorin Ekzekutiv dhe mbi Drejtorët, në marrëveshje me Drejtorin Ekzekutiv;
 - (i) jep opinionet e tij mbi rregulloren e tarifave dhe pagesave të përmendura në nenin 53 pika (1);
 - (j) vendos Rregullat e Procedurës;
 - (k) vendos mbi masat gjuhësore të Agjencisë;
 - (l) plotëson, sipas rastit, listën e dokumenteve të përmendur në nenin 23(1);
 - (m) vendos strukturën organizative të Agjencisë dhe miraton politikën e personelit të saj.

3. Bordi Drejtues mund të këshillojë Drejtorin Ekzekutiv për çdo çështje të lidhur ngushtë me zhvillimin strategjik të sigurisë së aviacionit, duke përfshirë kërkimin sipas përcaktimit në nenin 17.

4. Bordi Drejtues themelon një organ këshillimor të palëve të interesuara, me të cilin ai këshillohet para marrjes së vendimeve në fushat e përmendura në paragrafin 2(c), (e), (f) dhe (i). Bordi Drejtues mund të vendosë gjithashtu të këshillohet me organin këshillimor për çështje të tjera në lidhje me paragrafët 2 dhe 3. Bordi Drejtues nuk është varet nga opinioni i organit këshillimor.

Neni 25

Përbërja e Bordit Drejtues

1. Bordi Drejtues përbëhet nga një përfaqësues i çdo Shteti Anëtar dhe një përfaqësues i Komisionit. Për këtë qëllim, çdo Shtet Anëtar dhe Komisioni emërojnë një anëtar të Bordit Drejtues dhe një zëvendësues që do ta zëvendësojë atë në mungesë të tij/saj. Kohëzgjatja e mandatit kohor është tre vjet. Mandati kohor është i rinovueshëm.

2. Sipas rastit, pjesëmarrja e përfaqësuesve të vendeve të treta evropiane dhe kushtet e saj, përcaktohen në masat e përmendura në nenin 55.

Neni 26

Kryesia e Bordit Drejtues

1. Bordi Drejtues zgjedh një kryetar dhe një zëvendëskryetar nga anëtarët e vet. Zëvendëskryetari zëvendëson ex-officio kryetarin në rast të pengimit të tij/saj në ushtrimin e detyrave të tij/saj.

2. Mandati i kryetarit dhe zëvendëskryetarit përfundon me mbarimin e anëtarësisë së tyre respektive në Bordin Drejtues. Në përputhje me këtë dispozitë, kohëzgjatja e mandatit të kryetarit ose zëvendëskryetarit është tre vjet. Këto mandate janë të rinovueshme.

Neni 27

Mbledhjet

1. Mbledhjet e Bordit Drejtues thirren nga Kryetari.

2. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë merr pjesë në diskutime.

3. Bordi Drejtues mban të paktën dy mbledhje të zakonshme në vit. Përveç kësaj, ai mblidhet me kërkesën e kryetarit ose me kërkesë të të paktën një të tretës së anëtarëve të tij.
4. Bordi Drejtues mund të ftojë çdo person, mendimi i të cilit mund të jetë me interes, të marrë pjesë në mbledhje si vëzhgues.
5. Anëtarët e Bordit Drejtues, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Procedurës, mund të asistohet nga këshilltarë ose ekspertë.
6. Sekretariati për Bordin Drejtues krijohet nga Agjencia.

Neni 28

Votimi

1. Pa cënuar nenin 30 pika (1), Bordi Drejtues i merr vendimet e veta me një shumicë prej dy të tretave të anëtarëve të tij. Me kërkesë të një anëtari të Bordit Drejtues, vendimi i përmendur në nenin 24 pika (2)(k) merret me unanimitet.
2. Çdo anëtar ka një votë. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë nuk voton, Në mungesë të një anëtari, zëvendësi i tij/saj ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e tij/saj për të votuar.
3. Rregullat e procedurës përcaktojnë masa më të detajuara votimi, veçanërisht, kushtet për një anëtar për të vepruar në emër të një anëtari tjetër si dhe çdo kërkesë kuorumi, sipas rastit.

Neni 29

Funksionet dhe kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

1. Agjencia drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv, që është tërësisht i pavarur në ushtrimin e detyrave të tij/saj. Pa cënuar kompetencat përkatëse të Komisionit dhe Bordit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv nuk kërkon dhe nuk merr udhëzime nga asnjë qeveri ose nga asnjë organ.
2. Parlamenti Evropian ose Këshilli mund të ftojë Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë të raportojë mbi kryerjen e detyrave të tij/saj.
3. Drejtori Ekzekutiv ka funksionet dhe kompetencat e mëposhtme:
 - (a) aprovon masat e Agjencisë sipas përcaktimit në nenet 13 dhe 15 brenda kufijve të përcaktuara nga kjo Rregullore, rregullave në zbatim të saj dhe çdo ligj të zbatueshëm;

- (b) vendos mbi inspektimet dhe hetimet sipas parashikimit të neneve 45 dhe 46;
- (c) u cakton detyra certifikimi Autoriteteve të Brendshme të Aviacionit ose subjekteve të kualifikuara në përputhje me udhëzimet e caktuara nga Bordi Drejtues;
- (d) ushtron çdo funksion ndërkombëtar dhe bashkëpunim teknik me vendet e treta në përputhje me nenin 18;
- (e) merr të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë miratimin e udhëzimeve të brendshme administrative dhe publikimin e njoftimeve, për të siguruar funksionimin e Agjencisë në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje;
- (f) përgatit çdo vit një projekt raport të përgjithshëm dhe ia paraqet Bordit Drejtues;
- (g) ushtron në lidhje me personelin kompetencat e parashikuara në nenin 20(2);
- (h) bën vlerësime të të ardhurave dhe shpenzimeve të Agjencisë në përputhje me nenin 48, dhe zbaton buxhetin në përputhje me nenin 49;
- (i) u delegon kompetencat e tij/saj anëtarëve të tjerë të personelit të Agjencisë në përputhje me rregullat që miratohen sipas procedurës së përmendur në nenin 54(2);
- (j) me pëlqimin e Bordit Drejtues, merr një vendim në lidhje me ngritjen e zyrave lokale në Shtetet Anëtare në përputhje me nenin 19(3).

Neni 30

Emërimi i nëpunësve të lartë

1. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë emërohet mbi bazën e meritave dhe aftësive të dokumentuara dhe eksperiencës në lidhje me aviacionin civil ose pushohet nga Bordi Drejtues me propozim të Komisionit. Bordi Drejtues i merr vendimet e veta me një shumicë prej tre të katërtash të anëtarëve të tij.
2. Drejtori Ekzekutiv mund të asistohet nga një ose më shumë drejtorë. Nëse drejtori ekzekutiv mungon ose është i padisponueshëm, vendin e tij/saj e zë një prej drejtorëve.
3. Drejtorët e Agjencisë emërohen mbi bazën e aftësive profesionale në lidhje me aviacionin civil ose pushohen nga Bordi Drejtues me propozim të Drejtorit Ekzekutiv.

4. Kohëzgjatja e mandatit të Drejtorit Ekzekutiv dhe e Drejtorëve është pesë vjet. Ky mandat është me të drejte ripërtëritjeje.

Neni 31

Kompetencat e Bordit të Apeliti

1. Brenda Agjencisë, janë një ose më shumë Borde Apeliti.
2. Bordi ose Bordet e Apeliti janë përgjegjës për të vendosur mbi ankimet kundër vendimeve që përmenden në nenin 35.
3. Bordi ose Bordet e Apeliti mblidhen kur është e nevojshme. Numri i Bordeve të Apeliti dhe caktimi i punës vendoset nga Komisioni në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 54 pika (3).

Neni 32

Përbërja e Bordeve të Apeliti

1. Një Bord Apeliti përbëhet nga një Kryetar dhe dy anëtarë të tjerë.
2. Kryetari dhe dy anëtarët kanë zëvendës që i përfaqësojnë ata në mungesë të tyre.
3. Kryetari, anëtarët e tjerë dhe zëvendësit e tyre përkatës emërohen nga Bordi Drejtues nga një listë e kandidatëve të kualifikuar të miratuar nga Komisioni.
4. Nëse Bordi i Apeliti mendon që këtë e kërkon natyra e ankimit, ai mund të thërresë deri në dy anëtarë të tjerë nga lista e sipërpërmendur për atë çështje.
5. Kualifikimet e kërkuara për anëtarët e çdo Bordi Apeliti, kompetencat e anëtarëve të veçantë në fazën përgatitore të vendimeve dhe kushtet e votimit, përcaktohen nga Komisioni në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 54(3).

Neni 33

Anëtarët e Bordeve të Apeliti

1. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Bordeve të Apeliti, duke përfshirë kryetarin dhe zëvendësit e tyre përkatës, është pesë vjet. Ky mandat është i ripërtëritshëm.
2. Anëtarët e Bordeve të Apelit janë të pavarur. Në marrjen e vendimeve të tyre ata nuk varen nga udhëzimet.

3. Anëtarët e Bordeve të Apelit nuk mund të ushtrojnë asnjë detyrë tjetër në Agjenci. Funkzioni i anëtarëve të Bordeve të Apelit mund të jetë një funksion me orar të reduktuar.

4. Anëtarët e Bordeve të Apelit nuk mund të largohen nga detyra ose nga lista gjatë afateve të tyre përkatëse, përveç kur ka shkaqe serioze për një largim të tillë dhe Komisioni, pas marrjes së mendimit të Bordit Drejtues, merr një vendim në lidhje me këtë.

Neni 34

Përrjashtimi dhe mospranimi

1. Anëtarët e Bordeve të Apelit nuk mund të marrin pjesë në procedurat ankimore nëse ata kanë një interes personal në të ose nëse ata janë përfshirë më parë si përfaqësues i një prej palëve në procedurë, ose nëse ata kanë marrë pjesë në vendimin e ankimuar.

2. Nëse për një nga arsyet e përmendura në paragrafin 1 ose për çdo arsye tjetër, një anëtar i Bordit të Apelit mendon që ai/ajo nuk duhet të marrë pjesë në një procedurë ankimi, ai/ajo informon përkatësisht Bordin e Apelit.

3. Anëtarët e Bordeve të Apelit mund të përjashtohen nga çdo palë në procedurën e ankimit për një nga arsyet e përmendura në paragrafin 1, ose nëse dyshohet për anësi. Një kundërshtim nuk është i pranueshëm, nëse, duke qenë në dijeni të një shkakut përjashtues, pala në procedurën ankimore ka ndërmarrë një veprim procedural. Asnjë përjashtim nuk mund të bazohet në shtetësinë e anëtarëve.

4. Bordet e Apelimeve vendosin në lidhje me veprimet që duhen ndërmarrë në rastet e përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 pa pjesëmarrjen e anëtarëve të interesuar. Për qëllimet e marrjes së vendimit, anëtari i interesuar zëvendësohet në Bordin e Apelit nga zëvendësi i tij/saj.

Neni 35

Vendimet e ankimueshme

1. Ankim mund të bëhet kundër atyre vendimeve të Agjencisë që janë marrë në përputhje me nenet 15, 46 dhe 53.

2. Ankimimi bërë në përputhje me paragrafin 1 të mësipërm nuk ka efekt pezullues. Megjithatë, Agjencia, nëse ajo mendon që e lejojnë rrethanat, mund të pezullojë zbatimin e vendimit të kundërshtuar.

3. Ankimimi kundër një vendimi që nuk përfundon procedurën në lidhje me një nga palët mund të bëhet vetëm së bashku me një ankimim kundër vendimit përfundimtar, përveç kur vendimi parashikon ankimime të veçanta.

Neni 36

Personat me të drejtë ankimimi

Çdo person fizik ose juridik mund të bëjë ankimim kundër një vendimi që i drejtohet atij personalisht, ose një vendimi që, megjithëse nga forma i drejtohet një personi tjetër, e prek personin e parë drejtpërdrejt ose individualisht. Palët në shqyrtim mund të jenë palë në procedurat ankimuese.

Neni 37

Kufizimi kohor dhe forma

Ankimimi, së bashku me deklarin e arsyeve të tij, paraqitet me shkrim tek Agjencia brenda dy muajve nga njoftimi i masës personit përkatës, ose në mungesë të saj, nga dita në të cilën ai ka marrë dijeni për këtë të fundit, sipas rastit.

Neni 38

Rishikimi i ndërmjetëm

1. Nëse Drejtori Ekzekutiv mendon se ankimimi është i pranueshëm dhe i mirëbazuuar, ai/ajo korrigjon vendimin. Kjo nuk zbatohet nëse pala ankimuese është në mosmarrëveshje me një palë tjetër në shqyrtimin e ankimimit.

2. Nëse vendimi nuk korrigjohet brenda një muaji pas marrjes së deklarin të arsyetimit të ankimimit, Agjencia vendos menjëherë nëse do të pezullojë ose jo zbatimin e vendimit në përputhje me fjalinë e dytë të nenit 35 pika (2), dhe ia kthen ankimimin Bordit të Apelit..

Neni 39

Shqyrtimi i ankimimeve

1. Nëse ankimimi është i pranueshëm, Bordi i Ankimimit shqyrton nëse ankimimi është i mirëbazuuar.

2. Gjatë shqyrtimit të ankimimit, Bordi i Ankimimit vepron me shpejtësi. Ai i fton palët sa shpesh të jetë e nevojshme në shqyrtimin e ankimimit për të paraqitur vërejtjet e tyre mbi njoftimet e bëra prej tij ose mbi komunikimet nga palët e tjera në shqyrtimin e ankimimit, brenda afateve kohore të caktuara. Palët në shqyrtimin e ankimimit kanë të drejtë të bëjnë prezantime gojore.

Neni 40

Vendimet mbi ankimimin

Bordi i Ankimimit mund të ushtrojë çdo kompetencë që përfshihet brenda kompetencës së Agjencisë ose ai mund t'i kalojë çështjen organit kompetent të Agjencisë. Ky i fundit është i detyruar të marrë parasysh vendimin e Bordit të Ankimimit.

Neni 41

Veprimet para Gjykatës së Drejtësisë

1. Ankimimi në Gjykatën e Drejtësisë kundër vendimeve të Bordit të Ankimimit mund të bëhet brenda kushteve dhe termave të parashikuara në nenin 230 të Traktatit.
2. Nëse Agjencia nuk mund të marrë vendim, shqyrtimi për mosveprim mund t'i kalohet Gjykatës së Drejtësisë brenda termave dhe kushteve të parashikuara në nenin 232 të Traktatit.
3. Agjencisë i kërkohet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur vendimin e Gjykatës së Drejtësisë.

Neni 42

Ankimimi i drejtpërdrejtë

Shtetet Anëtare dhe institucionet e Komunitetit mund të bëjnë ankimim të drejtpërdrejtë tek Gjykata e Drejtësisë kundër vendimeve të Agjencisë.

Seksioni III

Metodat e Punës

Neni 43

Proçedurat për zhvillimin e opinionëve, specifikimet e çertifikimit dhe materialin udhëzues

1. Sa më parë të jetë e mundur pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Bordi Drejtues vendos procedura transparente për dhënien e opinioneve, specifikimin e certifikimit dhe materialit udhëzues të përmendur në nenin 13 pikat (a) dhe (b).

Këto procedura:

(a) mbështeten në ekspertizën që ofrohet nga autoritetet rregullatore të aviacionit të Shteteve Anëtare;

(b) nëse është e nevojshme, angazhojnë ekspertë të përshtatshëm nga palët përkatëse të interesuara;

(c) sigurojnë që Agjencia të publikojë dokumente dhe konsultohet gjerësisht me palët e interesuara, sipas një orari dhe një procedure që përfshin detyrimin për Agjencinë për të bërë një përgjigje me shkrim për procesin e konsultimit.

2. Kur Agjencia, në përputhje me nenin 14, jep opinione, specifikime certifikimi dhe material udhëzues për t'u zbatuar nga Shtetet Anëtare, ajo vendos një procedurë konsultimi me çdo Shtet Anëtar. Kështu, ajo mund të krijojë një grup pune në të cilin çdo Shtet Anëtar ka të drejtë të caktojë një ekspert.

3. Masat e përmendura në nenin 13 pikat (a) dhe (b) dhe procedurat e caktuara në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni publikohen në një publikim zyrtar të Agjencisë.

4. Procedurat e veçanta vendosen për të shqyrtuar veprimin e menjëhershëm që duhet të merret nga Agjencia për të reaguar ndaj një problemi sigurie dhe për të informuar palët përkatëse të interesuara në lidhje me veprimin që do të ndërmerret.

Neni 44

Procedurat për marrjen e vendimeve

1. Bordi Drejtues cakton procedura transparente për marrjen e vendimeve individuale sipas parashikimit në nenin 13 pika (c).

Këto procedura:

(a) sigurojnë dëgjimin e personave fizikë dhe juridikë që përmenden në vendim dhe çdo palë tjetër që preket drejtpërdrejt dhe individualisht;

(b) parashikon njoftimin e vendimit një personi fizik dhe juridik dhe publikimin e tij;

(c) siguron informacion për personat fizikë dhe juridikë të cilëve u drejtohet vendimi dhe për çdo palë tjetër në shqyrtim, për mjetet ligjore të mbrojtjes në dispozicion të atij personi në bazë të kësaj Rregulloreje;

(d) siguron që vendimi të jetë i arsyetuar.

2. Bordi Drejtues vendos gjithashtu procedura ku specifikohen kushtet në të cilat njoftohen vendimet duke patur mirë parasysh procedurën e ankimimit.

3. Procedurat e veçanta vendosen për të rregulluar vendimet e menjëhershme që duhet të merren nga Agjencia për të reaguar ndaj një problemi sigurie dhe të informojë palët përkatëse të interesuara për veprimin që ato duhet të marrin.

Neni 45

Inspektimet e Shteteve Anëtare

1. Pa cënuar kompetencat ekzekutive që i jepen Komisionit nga Traktati, Agjencia asiston Komisionin në monitorimin e zbatimit të kësaj Rregulloreje dhe rregullave në zbatim të saj, duke kryer inspektime standardizimi tek autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare sipas parashikimit në nenin 16 pika (1). Nëpunësit e autorizuar në bazë të kësaj Rregulloreje dhe autoritetet e brendshme marrin detyrë që në përputhje me dispozitat ligjore të Shteteve Anëtare përkatëse:

(a) të shqyrtojnë regjistrat, të dhënat dhe procedurat përkatëse, si dhe çdo material tjetër që ka të bëjë me arritjen e nivelit të sigurisë në aviacion në përputhje me këtë Rregullore;

(b) të marrë kopje ose pjesë nga këto regjistra, të dhëna, procedura dhe materiale të tjera;

(c) të kërkojë për shpjegime gojore në vend;

(d) të hyjë në çdo ambient, truall, ose mjet përkatës transporti.

2. Nëpunësit e Agjencisë të autorizuar për qëllimin e këtyre inspektimeve ushtrojnë kompetencat e tyre me paraqitjen e një autorizimi me shkrim që përcakton objektin, qëllimin e inspektimit dhe datën në të cilën duhet të fillojë. Në një kohë të përshtatshme para inspektimit, Agjencia informon Shtetin Anëtar në lidhje me inspektimin dhe identitetin e nëpunësve të autorizuar.

3. Shteti Anëtar i interesuar i pranon këto inspektime dhe siguron që organet dhe personat e interesuar të pranojnë gjithashtu këto inspektime.

4. Nëse inspektimi sipas termave të këtij neni shkakton një inspektim të një sipërmarrjeje ose shoqatë sipërmarrjesh, zbatohen dispozitat e nenit 46. Nëse një sipërmarrje e kundërshton këtë inspektim, Shteti Anëtar përkatës ofron të gjithë asistencën e nevojshme për nëpunësit e autorizuar nga Agjencia për t'u dhënë mundësi atyre të bëjnë inspektimin.

5. Raportet e hartuara në zbatim të këtij neni ofrohen në gjuhën(t) zyrtare të Shtetit Anëtar ku është kryer inspektimi.

Neni 46

Hetimi i sipërmarrjeve

1. Për zbatimin e nenit 15, Agjencia mund të zhvillojë vetë ose të ngarkojë autoritetet e brendshme të aviacionit ose subjekteve të interesuara të gjithë hetimin e nevojshëm të sipërmarrjeve. Hetimet zhvillohen në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të Shteteve Anëtare në të cilin ato duhet të ndërmerren. Për këtë qëllim, personat e autorizuar sipas kësaj Rregulloreje marrin kompetencë:

(a) të shqyrtojnë të gjitha regjistrat, të dhënat, procedurat përkatëse dhe çdo material tjetër që ka të bëjë me ekzekutimin e detyrave të Agjencisë;

(b) të marrë kopje ose pjesë nga këto regjistra, të dhëna, procedura ose materiale të tjera;

(c) të kërkojë shpjegim gojor në vend;

(d) të futet të ambientet, truallin ose mjetet përkatëse të transportit të sipërmarrjeve.

2. Personat e autorizuar për qëllimin e këtyre hetimeve ushtrojnë kompetencat e tyre me paraqitjen e një autorizimi me shkrim që përmban objektin dhe qëllimin e hetimit.

3. Në një moment të përshtatshëm para hetimit, Agjencia informon Shtetin Anëtar të interesuar në territorin e të cilit duhet të kryhet hetimi, në lidhje me hetimin dhe identitetin e personave të autorizuar. Nëpunësit e Shteteve Anëtare të interesuara, me kërkesë të Agjencisë, asistojnë personat e autorizuar në zbatimin e detyrave të tyre.

Neni 47

Transparenca dhe komunikimi

1. Agjencia i nënshtrohet Rregullores (KE) Nr 1049/2001 gjatë trajtimit të kërkesave për hyrjen në dokumentet e mbajtura prej saj.
2. Agjencia mund të komunikojë kryesisht në fushat brenda misionit të saj. Veçanërisht ajo siguron që, përveç publikimit të përcaktuar në nenin 43 pika (3), publikut dhe çdo pale të interesuar t'i jepet menjëherë informacion objektiv, i besueshëm dhe i kuptueshëm në lidhje me punën e saj.
3. Bordi Drejtues përcakton masat praktike për zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2.
4. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë t'i drejtohet me shkrim vetë Agjencisë në një nga gjuhët e përmendura në nenin 314 të Traktatit. Ai/ajo ka të drejtë të marrë përgjigje në të njëjtën gjuhë.

Seksioni IV

Kërkesa Financiare

Neni 48

Buxheti

1. Të ardhurat e Agjencisë përbëhen nga:
 - (a) një kontribut nga Komuniteti dhe nga çdo vend i tretë Evropian me të cilin Komuniteti ka përfunduar marrëveshjet e përmendura në nenin 55;
 - (b) tarifat e paguara nga kërkuesit dhe zotëruesit e çertifikatave dhe aprovimeve të nxjerra nga Agjencia; dhe
 - (c) pagesat për publikimet, trajnimet dhe shërbimet e tjera që ofrohen nga Agjencia.
2. Shpenzimet e Agjencisë përfshijnë shpenzimet për personelin, administrative, infrastrukturore dhe operative.
3. Drejtori Ekzekutiv përpilon një vlerësim të të ardhurave dhe shpenzimeve të Agjencisë për vitin financiar pasues dhe ia paraqet atë Bordit Drejtues së bashku me një plan organizativ.
4. Të ardhurat dhe shpenzimet janë të balancuara.
5. Bordi Drejtues, jo më vonë se 31 Marsi, miraton projekt vlerësimet, duke përfshirë planin provizor organizativ të shoqëruar nga programi paraprak i punës dhe ia paraqet këto Komisionit dhe shteteve me të cilat Komuniteti ka lidhur marrëveshjet e përmendura në nenin 55.

Mbi bazën e këtij buxheti, Komisioni cakton vlerësimet përkatëse në projekt buxhetin e përgjithshëm provizor të Bashkimit Evropian, që ia paraqet Këshillit në përputhje me nenin 272 të Traktatit. Duhet të merret parasysh perspektiva e objektit të buxhetit të aprovuar të Komunitetit për vitet në vazhdim.

Pas marrjes së projekt buxhetit, Shtetet e përmendur në nënparagrafin e parë përpilojnë projekt buxhetin e tyre paraprak.

6. Pas miratimit të buxhetit të përgjithshëm nga autoriteti buxhetor, Bordi Drejtues miraton buxhetin përfundimtar dhe programin e punës të Agjencisë, duke i përshtatur ato sipas nevojës me kontributin e Komunitetit. Ai ia paraqet ato pa vonesë Komisionit dhe autoritetit të buxhetit.

7. Çdo modifikim në buxhet, duke përfshirë planin e hartimit, respekton procedurën e përmendur në paragrafin 5.

Neni 49

Zbatimi dhe kontrolli i buxhetit

1. Drejtori Ekzekutiv zbaton buxhetin e Agjencisë.

2. Kontrolli i përkushtimit dhe pagesës për të gjitha shpenzimet dhe kontrolli i ekzistencës dhe përfutimit të të gjithë të ardhurave të Agjencisë kryhet nga Kontrollori Financiar i Komisionit.

3. Jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, Drejtori Ekzekutiv i paraqet Komisionit, Bordit Drejtues dhe Gjykatës së Auditëve llogari të detajuara për të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet nga viti i mëparshëm financiar.

Gjykata e Auditëve i shqyrton këto llogari në përputhje me nenin 248 të Traktatit. Ai publikon një raport mbi aktivitetin e Agjencisë çdo vit.

4. Parlamenti Evropian, duke vepruar sipas rekomandimit të Këshillit, i jep leje Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë në lidhje me zbatimin e buxhetit.

Neni 50

Lufta kundër mashtrimit

1. Me qëllim që të luftohet mashtrimi, korrupsioni dhe aktivitetet e tjera të paligjshme zbatohen pa kufizim dispozitat e Rregullores (KE) Nr. 1073/1999 të

Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 maj 1999 në lidhje me hetimet e kryera nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) (8).

2. Agjencia aderon në Marrëveshjet Ndër-Institucionale të datës 25 maj 1999 në lidhje me hetimet e brendshme nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (ZEKM)(9) dhe nxjerr pa vonesë dispozitat e përshtatshme të zbatueshme për të punësuarit e Agjencisë.

3. Vendimet në lidhje me financimet dhe marrëveshjet dhe instrumentet zbatuese që rrjedhin prej tyre, parashikojnë shprehimisht që Gjykata e Auditëve dhe ZEKM mund të kryejnë, sipas nevojës, kontrolle në vend tek përfituesit e financimit të Agjencisë dhe agjentëve përgjegjës për alokimin e tij.

Neni 51

Vlerësimi

1. Brenda tre viteve nga data që Agjencia ka marrë përsipër përgjegjësitë e saj dhe në çdo pesë vjet pas kësaj, Bordi Drejtues autorizon një vlerësim të pavarur të jashtëm mbi zbatimin e kësaj Rregulloreje.

2. Vlerësimi shqyrton efikasitetin e përmbushjes së misionit nga Agjencia. Ai vlerëson gjithashtu ndikimin e kësaj Rregulloreje, Agjencinë dhe praktikën e saj të punës në vendosjen e një niveli të lartë të sigurisë së aviacionit civil. Vlerësimi merr parasysh mendimet e aktorëve, në nivel evropian dhe të brendshëm.

3. Bordi Drejtues merr konstatimet e vlerësimit dhe i paraqet rekomandime në lidhje me ndryshimet në këtë Rregullore, Agjenci dhe praktikën e saj të punës Komisionit, që mund t'ia kalojë këto, së bashku me mendimin e vet si dhe propozimet e përshtatshme, Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Sipas rastit përfshihet një plan pune dhe një afat kohor. Si konstatimet ashtu edhe rekomandimet e vlerësimit bëhen publike.

Neni 52

Dispozita financiare

Bordi Drejtues, pasi ka marrë pëlqimin e Komisionit dhe opinionin e Gjykatës së Auditëve, miraton Rregulloren Financiare të Agjencisë, që përcakton veçanërisht procedurën që përdoret për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Agjencisë në përputhje me nenin 142 të Rregullores Financiare që zbatohet për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Evropiane.

Neni 53

Rregullore e tarifave dhe pagesave

1. Komisioni, duke vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 54 pika (3) dhe pas konsultimit me Bordin Drejtues miraton një rregullore mbi tarifat dhe pagesat.

2. Rregullorja e tarifave dhe pagesave përcakton veçanërisht çështjet për të cilat paguhen tarifa dhe pagesa në përputhje me nenin 48 pika (1), shumën e tarifave dhe pagesave dhe mënyrën në të cilën ato duhet të paguhen.

3. Tarifat dhe pagesat caktohen për:

(a) lëshimin dhe rinovimin e certifikatave, si dhe funksionet përkatëse të vazhdueshme të mbikëqyrjes;

(b) dhënien e shërbimeve; ato reflektojnë koston faktike të çdo shërbimi të veçantë;

(c) shqyrtimin e ankimeve.

Të gjitha tarifat dhe pagesat shprehen dhe paguhen në Euro.

4. Shuma e tarifave dhe pagesave përcaktohet në një nivel të tillë që të sigurojë që të ardhurat në lidhje me to në parim, janë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet e shërbimeve të dhëna.

Kontributi i përmendur në nenin 48 pika (1), për një periudhë transitorë që përfundon në 31 dhjetor të vitit të katërt nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, mbulon shpenzimet që kanë të bëjnë me fazën fillestare të punës së Agjencisë. Në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 54 pika (3), kjo periudhë mund të shtyhet, nëse është e nevojshme, për jo më shumë se një vit.

Kapitulli IV

Dispozitat Përfundimtare

Neni 54

Komiteti

1. Komisioni asistohet nga një komitet.

2. Nëse bëhet referencë në këtë paragraf, zbatohen nenet 3 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE duke patur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

3. Nëse bëhet referencë në këtë paragraf, zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE duke patur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

Periudha e parashikuar në nenin 5 pika (6) të Vendimit 1999/468/KE caktohet një muaj.

4. Nëse bëhet referencë në këtë paragraf, zbatohet neni 6 i Vendimit 1999/468/KE.

Para miratimit të vendimit të tij, Komisioni konsultohet me komitetin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Periudha e parashikuar në nenin 6 pika (b) të Vendimit 1999/468/KE caktohet tre muaj.

Nëse një vendim Komisioni i referohet Këshillit nga një Shtet Anëtar, Këshilli, duke vepruar me shumicë të cilësuar, mund të marrë një vendim të ndryshëm brenda një periudhe prej tre muajsh.

5. Komiteti miraton Rregullat e tij të Proçedurës.

Neni 55

Pjesëmarrja e vendeve të treta evropiane

Agjencia është e hapur për pjesëmarrjen e vendeve të treta evropiane që janë palë kontraktuese në Konventën e Çikagos dhe që kanë lidhur marrëveshje me Komunitetin Evropian nëpërmjet të cilit ata kanë miratuar dhe po zbatojnë të drejtën komunitare në fushën e mbuluar nga kjo Rregullore dhe rregullat në zbatim të saj.

Në bazë të dispozitave përkatëse të këtyre marrëveshjeve, do të zhvillohen masa që, ndërmjet të tjerash, specifikojnë natyrën dhe masën e tyre, dhe rregullat e detajuara për pjesëmarrjen e këtyre vendeve në punën e Agjencisë, duke përfshirë dispozitat e kontributeve financiare dhe personelit.

Neni 56

Fillimi i aktivitetit të Agjencisë

1. Agjencia kryen funksionet e një organi çertifikues që i caktohen asaj në bazë të nenit 15 që nga data 28 shtator 2003. Deri në atë datë, Shtetet Anëtare vazhdojnë të zbatojnë legjislacionin dhe rregullat e zbatueshme.

2. Gjatë periudhës tranzitore prej 42 muajsh nga data e përmendur në paragrafin 1, Shtetet Anëtare mund të vazhdojnë të lëshojnë çertifikata dhe aprovime nëpërmjet

devijimit nga dispozitat e neneve 5, 6, 9 dhe 15 në bazë të kushteve të përcaktuara nga Komisioni në rregullat zbatuese të miratuara për aplikimin e tyre. Nëse në këtë kontekst Shtetet Anëtare lëshojnë çertifikata mbi bazën e çertifikatave të dhëna nga vendet e treta, Komisioni, duke zbatuar rregullat, shqyrton siç duhet, parimet e parashikuara në nenin 9 pikat (2)(b) dhe (c).

3. Nëpërmjet devijimit nga dispozitat e nenit 43, në pritje të miratimit të kërkesave thelbësore në përputhje me nenin 7, zbatimi i detyrave përkatëse nga Agjencia i nënshtrohet procedurave të punës të rëna dakord nga autoritetet e përbashkëta të aviacionit.

Neni 57

Shfuqizimi

1. Direktiva 80/51/KEE dhe Shtojca II e Rregullores (KEE) Nr 3922/91 shfuqizohet nga data 28 shtator 2003.

2. Parashikimet e nenit 8 zbatohen për produktet, pjesët dhe pajisjet, organizatat dhe personat që janë çertifikuar në përputhje me dispozitat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 58

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e 20-të pas asaj të publikimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Evropiane.

Nenet 5 dhe 6 zbatohen nga datat e përcaktuara në rregullat zbatuese.

Kjo Rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjithë Shtetet Anëtare.

Bërë në Bruksel, më 15 korrik 2002

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

P.Cox

Për Këshillin

Presidenti

M.Fischer Boel

- (1) GZ C 154 E, 29.5.2001, fq. 1.
- (2) GZ C 221, 7.8.2001, fq. 38.
- (3) Opinioni i Parlamentit Evropian i 5 shtatorit 2001(GZ C 72 E, 21.3.2002, fq. 146), Pozicioni i Përbashkët i Këshillit i 19 dhjetorit 2001 (GZ C 58 E, 5.3.2002, fq. 44) dhe Vendimi i Parlamentit Evropian i 9 prillit 2002 (e papublikuar në Gazetën Zyrtare). Vendim i Këshillit i 18 Qershorit 2002.
- (4) GZ L 145, 31.5.2001, fq. 43.
- (5) GZ L 184, 17.7.1999, fq. 23.
- (6) GZ L 18, 24.1.1980, fq. 26. Direktiva ndryshuar së fundmi nga Direktiva 83/206/KEE (GZ L 117, 4.5.1983, fq. 15).
- (7) GZ L 373, 31.12.1991, fq. 4. Rregullore me ndryshimet e Rregullores së Komisionit (KE) Nr 2871/2000 (GZ L 333, 29.12.2000, fq. 47).
- (8) GZ L 136, 31.5.1999, fq. 1.
- (9) GZ L 136, 31.5.1999, fq. 15.

Aneksi I

Kërkesa thelbësore për përshtatshmërinë për fluturim të përmendura në Nenin 5

1. Integriteti i produktit: integriteti i produktit duhet të garantohet për të gjitha kushtet e parashikueshme të fluturimit gjatë gjithë kohëzgjatjes funksionale të avionit. Përputhja me të gjitha kërkesat duhet të tregohet nëpërmjet vlerësimit të analizës, e mbështetur, sipas rastit, nëpërmjet testeve.

1.a. Strukturat dhe materialet: integriteti i strukturës duhet të garantohet tërësisht dhe në masën e mjaftueshme tek harku funksional i avionit, duke përfshirë sistemin shtytës, dhe e ruajtur gjatë gjithë kohëzgjatjes së funksionimit të avionit.

1.a.1. Të gjitha pjesët e avionit, mosfunksionimi i të cilave mund të pakësojë integritetin strukturor, duhet të përputhen me kushtet e mëposhtme pa deformim prishës ose defekt. Kjo përfshin të gjithë artikujt me masë të konsiderueshme dhe mjetet e tyre të kufizimit.

1.a.1.a. Duhet të merrem parasysh të gjitha kombinimet e ngarkesës që priten në mënyrë të arsyeshme të ndodhin brenda dhe në masë të mjaftueshme tej peshave, qendrës së gamës së gravitetit, harkut funksional dhe jetëgjatësisë së avionit. Kjo përfshin ngarkesa për shkak të kolpove, manovrimeve, presionit, sipërfaqeve të lëvizshme, sistemeve të kontrollit dhe shtytjes si në fluturim ashtu edhe në tokë.

1.a.1.b. Vëmendje duhet t'u kushtohet ngarkesave dhe defekteve të mundshme të shkaktuara nga uljet e emergjencës në tokë ose në ujë.

1.a.1.c. Efektet dinamike duhet të mbulohen në reagimin strukturor ndaj këtyre ngarkesave.

1.a.2. Avioni duhet të jetë i lirë nga paqëndrueshmëria aeroelastike dhe vibrimi i tepërt.

1.a.3. Proçeset dhe materialet prodhuese të përdorura në ndërtimin e avionit duhet të rezultojnë në cilësi strukturale të njohura dhe të riprodhueshme. Duhet të arsyetohet çdo ndryshim në punën me materialin në lidhje me ambientin funksional.

1.a.4. Efektet e ngarkimit ciklik, degradimit të ambientit, dhe dëmtimi aksidental dhe i qartë burimor nuk duhet të pakësojë integritetin strukturor tej një niveli të pranueshëm fuqie të mbetur. Të gjitha udhëzimet e nevojshme për të siguruar

përshtatshmërinë e vazhdueshme për fluturim në këtë aspekt duhet të bëhen të ditura.

1.b. Fuqia shtytëse: integriteti i sistemit shtytës (d.m.th, motori dhe, sipas rastit, helika) duhet të demonstrohet tërësisht dhe në masën e mjaftueshme të harkut funksional të sistemit shtytës dhe duhet të ruhet gjatë gjithë kohëzgjatjes funksionale të sistemit shtytës.

1.b.1. Sistemi shtytës duhet të prodhojë, brenda kufijve të caktuar, forcën shtytëse ose fuqinë e kërkuar prej tij në të gjitha kushtet e kërkuara të fluturimit, duke marrë parasysh efektet dhe kushtet e ambientit.

1.b.2. Proçesi i fabrikimit dhe materialet që përdoren në ndërtimin e sistemit shtytës duhet të rezultojnë në sjellje strukturore të njohur dhe të riprodhueshme. Çdo ndryshim në rendimentin e materialit në lidhje me ambientin operativ duhet të bëhet i ditur.

1.b.3. Efektet e ngarkimit ciklik, degradimi i ambientit dhe funksional si dhe defektet e mundshme të mëvonshme të pjesëve nuk duhet të pakësojnë integritetin e sistemit të shtytjes tej niveleve të pranueshëm. Të gjitha udhëzimet për të siguruar përshtatshmërinë e vazhdueshme për fluturim në këtë aspekt duhet të bëhen të ditura.

1.b.4. Të gjitha udhëzimet, informacioni dhe kërkesat e nevojshme për interfazimin e sigurt dhe të saktë ndërmjet sistemit të shtytjes dhe avionit duhet të bëhen të ditura.

1.c. Sistemet dhe pajisjet

1.c.1. Avioni nuk duhet të ketë tipare ose detaje dizenoje që eksperiencia i ka treguar të jenë të rrezikshme.

1.c.2. Avioni, duke përfshirë ato sisteme, pajime ose pajisje që kërkohen për certifikimin e tipit, ose nëpërmjet rregullave operative, duhet të funksionojë sipas parashikimit në çdo kusht të parashikueshëm operativ, gjatë gjithë, dhe në masë të mjaftueshme tej harkut operativ të avionit duke marrë parasysh si duhet ambientin e funksionimit të sistemit, pajimeve ose pajisjeve. Sistemet, pajimet dhe pajisjet që nuk kërkohen për certifikimin e tipit ose nëpërmjet rregullave të përdorimit, qoftë duke funksionuar rregullisht ose jo rregullisht, nuk duhet të pakësojnë sigurinë dhe nuk duhet të ndikojnë negativisht në funksionimin e rregullt të ndonjë prej

sistemeve, pajimeve ose pajisjeve. Sistemet, pajimet ose pajisjet duhet të jenë të përdorshme pa pasur nevojë për aftësi ose fuqi të veçantë.

1.c.3. Sistemet e avionit, pajimet dhe pajisjet përkatëse, të marra veçmas ose në lidhje me njëra-tjetrën, duhet të jenë dizenuar në mënyrë të tillë që çdo gjendje defekti katastrofik nuk rezulton nga një defekt i vetëm që nuk tregohet të jetë ekstremisht e pamundur dhe duhet të ekzistojë një raport i kundërt ndërmjet mundësisë së një gjendjeje defekti dhe ashpërsisë së efektit të saj mbi avionin dhe personave brenda. Në lidhje me kriterin e mësipërm të një defekti të vetëm, pranohet që duhet të jepet mundësia për madhësinë dhe konfigurimin e gjerë të avionit dhe që kjo të parandalojë këtë kriter të defektit të vetëm të ndeshet tek disa pjesë dhe disa sisteme në helikopterë dhe aeroplanë të vegjël.

1.c.4. Informacioni që nevojitet për zhvillimin e sigurt të fluturimit dhe informacioni në lidhje me kushtet e pasigurta duhet të t'i jepen ekuipazhit ose personelit të mirëmbajtjes, sipas rastit, në një mënyrë të qartë të njëtrajshme dhe të kuptueshme. Sistemet, pajisjet dhe kontrollet, duke përfshirë shenjat dhe njoftimet duhet të dizenjohen dhe vendosen për të minimizuar gabimet që mund të kontribuonin në krijimin e rreziqeve.

1.c.5. Duhet të merren masa paraprake në dizënjim për të minimizuar rreziqet për avionin dhe personat brenda nga rreziqet normalisht të mundshme, si brenda ashtu edhe jashtë avionit, duke përfshirë mbrojtjen nga mundësia e një defekti të rëndësishëm, ose prishjen e një pajisjeje të avionit.

1.d. Përshtatshmëria e vazhdueshme për fluturim

1.d.1. Udhëzimet për përshtatshmërinë e vazhdueshme për fluturim duhet të hartohen për të siguruar që standardi i përshtatshmërisë për fluturim i certifikatës së tipit të avionit të ruhet gjatë gjithë jetëgjatësisë funksionale të avionit.

1.d.2. Duhet të sigurohen mjetet që mundësojnë inspektimin, përshtatjen, lubrifikimin, heqjen ose zëvendësimin e pjesëve dhe pajisjeve sipas nevojës për përshtatshmërinë e vazhdueshme për fluturim.

1.d.3. Udhëzimet për përshtatshmërinë e vazhdueshme për fluturim duhet të jenë në formën e një manuali ose manualeve, sipas rastit për sasinë e të dhënave që jepen, Manualet duhet të mbulojnë udhëzimet për mirëmbajtjen dhe riparimin, informacion për shërbimin, procedurat për rregullimin e defekteve dhe inspektimin, në një format që parashikon një rregullim praktik.

1.d.4. Udhëzimet për përshtatshmërinë e vazhdueshme për fluturim duhet të përmbajnë kufizimet e përshtatshmërisë për fluturim që caktojnë çdo afat të zëvendësimit të detyruar, intervalet e inspektimit dhe procedurën përkatëse të inspektimit.

2. Aspektet e përshtatshmërisë për fluturim të përdorimit të produktit

2.a Çështjet e mëposhtme duhet të demonstrohen që janë trajtuar për të siguruar një nivel të kënaqshëm sigurie për personat në bord dhe në tokë gjatë përdorimit të produktit.

2.a.1. Duhet të specifikohen llojet e operacioneve për të cilat është aprovuar avioni dhe duhet gjithashtu të tregohen kufizimet dhe informacioni i nevojshëm për përdorimin e sigurt, duke përfshirë kufizimet e ambientit dhe punën.

2.a.2. Avioni duhet të jetë i kontrollueshëm dhe i manovrueshëm në mënyrë të sigurt në të gjitha kushtet e pritshme funksionale duke përfshirë edhe defektin e një ose, sipas rastit, e shumë sistemeve të shtytjes. Duhet të merren parasysh si duhet fuqia e pilotit, ambienti në vendin e kontrollit të fluturimit, ngarkesa e punës së pilotit dhe faktorë të tjerë njerëzorë gjatë fazës së fluturimit dhe kohëzgjatjes së tij.

2.a.3. Duhet të jetë e mundur të bëhet një tranzicion i lehtë nga një fazë fluturimi në një tjetër pa patur nevojë për aftësi të veçanta pilotimi, vëmendje, fuqi, ngarkesë pune në të gjitha kushtet funksionale të mundshme.

2.a.4. Avioni duhet të ketë stabilitet të tillë që të sigurojë që kërkesat e bëra për pylonin të mos jenë të tepërta duke marrë parasysh fazën e fluturimit dhe kohëzgjatjen e saj.

2.a.5. Duhet të caktohen procedurat për funksionet normale, defektet dhe kushtet e emergjencës.

2.a.6. Duhet të jepen, sipas rastit, paralajmërimet për pengesat që synojnë pengimin e harkut normal kohor të tipit.

2.a.7 Karakteristikat e avionit dhe sistemeve të tij duhet të lejojnë një kthim të sigurt nga ekstremet e harkut të fluturimit ku mund të hasen.

2.b. Kufizimet funksionale dhe informacioni tjetër i nevojshëm për përdorimin e sigurt duhet t'u ofrohet anëtarëve të ekuipazhit.

2.c. Funkcionet e produktit duhet të mbrohen nga rreziqet që rrjedhin nga kushtet negative të jashtme dhe të brendshme, duke përfshirë kushtet ambjentaliste.

2.c.1. Veçanërisht, nuk duhet të shkaktohen gjendje të pasigurta nga ekspozimi ndaj fenomeneve të tilla, por pa u kufizuar në, si: moti i keq, vetëtimja, goditjet nga zogjtë, zonat me frekuencë të lartë rrezatimi, ozoni etj, që normalisht priten të ndodhin gjatë përdorimit të produktit.

2.c.2. Ambientet e pasagjerëve duhet t'u ofrojnë atyre kushte të përshtatshme transporti dhe mbrojtje të përshtatshme nga çdo rrezik i pritshëm që del gjatë funksioneve të fluturimit ose që dalin në situata emergjente, duke përfshirë zjarrin, tymin, gazrat toksike, dhe rreziqet e rënies së menjëhershme të presionit të ajrit. Duhet të merren masa që t'u jepet udhëtarëve çdo shans i arsyeshëm që mënjanon dëmtimin e rëndë dhe evakuon avionin dhe i mbron ata nga efekti i forcave të uljes së shpejtësisë në rastin e uljes së detyruar në tokë ose në ujë. Duhet të vendosen shenja ose njoftime të qarta dhe të kuptueshme, sipas rastit, për t'i udhëzuar udhëtarët në lidhje me sjelljen për siguri të përshtatshme dhe vendndodhjen dhe përdorimin e saktë të pajimeve të sigurisë. Pajimet e nevojshme të sigurisë duhet të jenë lehtësisht të kapshme.

2.c.3. Ambientet e ekuipazhit duhet të rregullohen në mënyrë që të lehtësohen funksionet e fluturimit duke përfshirë mjetet që sigurojnë ndërgjegjësimin sipas situatës dhe menaxhimin e çdo situatë ose emergjence të pritshme. Vendndodhja e ambienteve të ekuipazhit nuk duhet të rrezikojë aftësinë e ekuipazhit për të kryer detyrat e tyre dhe dizenjimi i tyre duhet të jetë i tillë që të mënjanojë ndërhyrjen gjatë funksionimit dhe keqpërdorimin e mjeteve të kontrollit.

3. Organizatat (duke përfshirë personat fizikë që ndërmarrin dizenjimin, prodhimin ose mirëmbajtjen)

3.a. Aprovimet për organizatat duhet të jepen nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

3.a.1. organizata duhet të ketë të gjitha mjetet e nevojshme për objektin e punës. Këto mjete përfshijnë, por nuk janë të kufizuara sa më poshtë: ambiente, personel, pajime, vegla dhe materiale, dokumentim të detyrave, përgjegjësive dhe procedurave, mundësinë për të parë ruajtjen e të dhënave dhe regjistrave;

3.a.2. organizata duhet të zbatojë dhe mbajë një sistem menaxhimi që të sigurojë përputhjen me këto kërkesa thelbësore për përshtatshmërinë për fluturim dhe të synojë përmirësimin e vazhdueshëm të këtij sistemi;

3.a.3. organizata duhet të marrë masa me organizatat e tjera përkatëse, sipas rastit, për të siguruar përputhshmërinë e vazhdueshme me këto kërkesa thelbësore për përshtatshmërinë për fluturim;

3.a.4. një organizatë duhet të vendosë një sistem raportimi dhe/ose trajtimi të ngjarjeve, që duhet të përdoret nga sistemi i drejtues sipas pikës 3.a.2 dhe masave të pikës 3.a.3, me qëllim që të kontribuojë për qëllimin e përmirësimit të vazhdueshëm të sigurisë së produkteve.

3.b. Në rastin e organizatave trajnuese për mirëmbajtjen, nuk zbatohen kushtet sipas pikave 3.a.3 dhe 3.a.4.

Aneksi II

Avioni i përmendur në Nenin 4(2)

Avionët për të cilët nuk zbatohet nenin 4(1) janë avionë për të cilët certifikata e tipit ose certifikata e përshtatshmërisë për fluturim nuk është lëshuar mbi bazën e kësaj Rregulloreje dhe rregullave të saj zbatuese dhe që përfshihen në një nga kategoritë e mëposhtme:

(a) avionët që kanë një rëndësi të qartë historike, në lidhje me:

(i) pjesëmarrjen në një ngjarje të rëndësishme historike, ose

(ii) një hap të rëndësishëm në zhvillimin e aviacionit; ose

(iii) një roli të rëndësishëm që ka luajtur në forcat e armatosura të një Shteti Anëtar;

Dhe që përmbush një ose disa nga kriteret e mëposhtme:

(i) dizenjua e tij fillestare vërtetohet të jetë më e vjetër se 40 vjet;

(ii) prodhimi i tij ka pushuar të paktën 25 vjet më parë;

(iii) në Shtetet Anëtare janë akoma të regjistruar më pak se 50 avionë të të njëjtës dizenjo bazë;

(b) avion i dizenuar ose modifikuar specifikisht për qëllime kërkimi, eksperimentale ose shkencore, dhe që mund të prodhohet vetëm në numra të vegjël;

(c) avionë ku të paktën 51% e të cilit është ndërtuar nga një amator, ose një shoqatë jo-fitimprurëse amatorësh, për qëllimet e tyre dhe pa objektiva tregtare;

(d) avionë dizenuar fillestare e të cilëve ishte planifikuar vetëm për qëllime ushtarake;

(e) avionë që nuk kanë më shumë se dy vende, dhe shpejtësia e uljes ose shpejtësia minimale e qëndrueshme e fluturimit në konfigurimin e uljes nuk e kalon shpejtësinë ajrore të kalibruar 35 nyje (CAS), dhe një masë maksimale ngritjeje (MTOM) jo më shumë se:

(i) 300 kg për një avion të zakonshëm, me një vend; ose

(ii) 450 kg për një avion të zakonshëm, me dy vende; ose

(iii) 330 kg për një amfib ose hidroplan me një vend; ose

(iv) 495 kg për një amfib ose hidroplan me dy vende, me kusht që, nëse të dy operojnë si hidroplane dhe si avionë të zakonshëm, bie poshtë të dy kufijve MTOM, sipas rastit;

(f) “avion pa motor dhe me vela” me një masë strukturore më të vogël se 80 kg nëse është me një vend ose 100 kg nëse është me dy vende, duke përfshirë ato mund të nisen me këmbë;

(g) avion pa ekuipazh me një masë operacionale më të vogël se 150 kg;

(h) çdo avion tjetër me një masë të përgjithshme pa pilonin më të vogël se 70 kg.